

E ENJTE DATA 23 SHKURT 2023

FJALA E DEPUTETES ANDIA ULLIRI

Të nderuar kolegë dhe të nderuar qytetarë,

Duhet thënë që pas shumë seancave, sot kjo duket si një situatë, ndoshta edhe pak qesharake, sepse neve na jepet fjala për të diskutuar, ndërkohë që kanë kaluar 5 seanca dhe neve na është mohuar e drejta e fjalës. Jemi hequr nga regjistri, ku jemi regjistruar për të folur dhe për të diskutuar, ndërkohë që janë votuar ligje padrejtësisht. Shoh drejt kabinetit qeveritar, i cili është komplet bosh. Mendoj se atyre u leverdis të qëndrojnë në ato situata, kur mund të thonë disa komente, ndoshta komente sarkastike, joserioze për diskutimet. Ndërkohë që në momentin e parë, kur na jepet e drejta e fjalës për të diskutuar, ata vendosin të dalin nga salla. Një deputet në këtë sallë, nuk është dhe nuk duhet të trajtohet si një njeri të cilit mund t'i zhvishet thjeshtësisht roli dhe besimi që ka marrë nga qytetarët shqiptarë. Parlamentarizmi, siç e dini, është cenuar nga qeveria për të shërbyer si zyrë noteriale dhe avokat i Kryeministrit, kur ai ndodhet në udhëtime për agjendën e tij. Ai nuk ndodhet në Shqipëri, ndërkohë që duhej të ishte para qytetarëve shqiptarë, para parlamentit, për të diskutuar dhe për të dhënë llogari, sepse e ka detyrim ligjor të japë llogari përpara qytetarëve shqiptarë për çdo situatë që ai krijon. Parlamentarizmi këtu është minuar seancë pas seance dhe qeveria nuk ka bërë asgjë më shumë se të duartrokasë pas çdo projektligji që kanë votuar padrejtësisht dhe në kundërshtim të hapur me Kushtetutën. Meritokracia, drejtësia dhe liria e fjalës janë ende çështje, fatkeqësisht, për të cilat ne duhet të luftojmë edhe brenda kësaj sale.

Nëse do t'u kthehesha seancave ku isha regjistruar si diskutante, do të kisha debatuar për shumë projektligje, sidomos të diskutoja për realitetin. Zonja Ministre, doja t'ju sillja në vëmendje situatën e trajtimit abuziv që po u bëhet banorëve të Bërxullës për projektin e aksit Thumanë-Kashar. E di që nuk keni interes të rrini dhe të dëgjoni, sepse, sa herë është përmendur kjo çështje, ju keni vendosur të largoheni nga salla pa dhënë asnjë përgjigje. A mund të na thoni pse ndodh kjo mungesë transparence dhe serioziteti ndaj pronarëve, të cilët do të shpronësohen me vlera shumë më të ulëta nga vlera e tregut? Personalisht, kam dërguar një shkresë për informacion, ku parashtraj pyetje për projektin e aksit Thumanë-Kashar. Në shkelje të Rregullores dhe të ligjit, keni kaluar afatin kohor për të kthyer përgjigje, por nuk tregoni aspak seriozitet kur largoheni nga salla. Ministrja dhe Ministria e Infrastrukturës është përgjegjëse për kthimin e përgjigjes dhe, me sa duket, mendojnë se mund të bëjnë çfarë të duan dhe t'i anashkalojnë edhe deputetët e parlamentit, duke harruar se janë në ato poste për të dhënë llogari për çdo pyetje dhe për t'i dhënë përgjigje çdo deputeti kur ai ka një pyetje për një projekt, sidomos për një projekt të tillë kaq fundamental, i cili është edhe çështje ndërkombëtare. A do të thotë kjo se ndoshta po fshihet diçka, apo ju jeni, mendoni se jeni, të pagabueshëm dhe mendoni se mund të anashkaloni çdo deputet, të bëni çdo ligj, të vini këtu, të kaloni çdo ligj, të mos votohet, të mos diskutohet dhe të përjashtoni edhe deputetë nga salla, vetëm sepse ju mendoni se keni të drejtën për ta bërë këtë gjë?!

Së pari, dua të di: cila palë do të jetë përgjegjëse për procesin e shpronësimit? Së dyti, dua të diskutoj në një seancë shumë të rëndësishme, siç është seanca për problemet dhe shqetësimet e zonës nga vij, e cila gjithmonë ka pasur një reputacion që nuk i takon ta ketë, përsëri për infrastrukturën dhe për çështjet kulturore, për faktin se kjo zonë gjithmonë anashkalohej. Pse ka mungesë hapësirash sportive

dhe kreative në qytetin e Fushë-Krujës? Pse nuk ka siguri në atë rrugë? Pse nuk ka ndriçim në rrugën nacionale Tiranë–Fushë-Krujë? Pse mungon energjia elektrike në një zonë të tillë të zhvilluar, me industri të zhvilluar, e cila nuk merr kurrë përkrahje? A mund të ma thotë ndonjë nga ato karriget bosh, ku ulen ministrat? A ka ndonjë përgjigje për të gjitha këto çështje?! A mund të flasim për tërmetin, diçka që na shqetëson edhe sot? E them këtë, sepse u bënë 4 vjet, por ka banorë të cilët nuk i kanë marrë shtëpitë që u premtuan. Projektet janë bërë, shtëpitë janë gati, disa ndoshta nuk janë, disa po përdoren për qëllime elektorale, siç është edhe ky ligj, që u parashtrua edhe nga zoti Gështenja, edhe nga zoti Korreshi, i cili përdoret vetëm për qëllime elektorale. Çfarë procesi do të ndiqet për shpërndarjen e këtyre shtëpive? Pse nuk ka një rregullore të përcaktuar për ndërtimin e projekteve të këtyre rezidencave? A mund të themi që kemi kaluar në një nivel tjetër, më afër Bashkimit Europian, ku ka certifikime dhe standarde për të përballuar aktivitetin sizmik? A mund të na thotë ndonjëri nga përfaqësuesit e qeverisë, që ne nuk duhet të kemi frikë që ajo çka ndodhi në Turqi, nuk do të ndodhë përsëri këtu, sepse për lëndët e para, për materialet dhe për mënyrën se si ndërtohet, ka certifikim? Më vjen shumë keq që i gjithë diskutimi im duket jashtë rendit të ditës, sepse, në fakt, të diskutojmë për problemet dhe shqetësimet e qytetarëve tanë është kthyer në luks të parlamentit; është kthyer në anomali të institucionit më të rëndësishëm në këtë Republikë. Më vjen shumë keq, sepse ndoshta ju nuk e merrni parasysh faktin që rinia po largohet, kriza e papunësisë zgjerohet, fshatrat boshatisen, profesionet po humbasin, degët po mbyllen. E gjithë kjo është thjesht pasojë e keq-qeverisjes suaj, për më tepër pasojë e çdo ligji që keni kaluar me duartrokitje boshe. Kush mban përgjegjësi për të gjithë këtë situatë dhe për të gjithë plagën e emigrimit? Pse nuk flasim sot për ato që shqetësojnë shqiptarët? Pse nuk vjen Kryeministri, të thotë e të përballet në parlament qoftë me deputetët e pozitës ose me ata të opozitës, për çështjen që ka cenuar sigurinë kombëtare të qyteteve, të shtetit tonë dhe të aleatëve tanë? E keni thyer Rregulloren dhe besimin e qytetarëve ndaj këtij institucioni, duke i trajtuar kolegët e opozitës si armiq. Keni abuzuar çdo ditë, për më tepër arrini të tregoni edhe një arrogancë të jashtëzakonshme, të pajustificueshme ndaj qytetarëve shqiptarë, sepse e kemi kuptuar që për deputetët e opozitës nuk është se keni ndonjë mënyrë, ose nuk e keni treguar, për trajtimin e tyre, sepse nuk i konsideroni, nuk keni konsideratë, le të themi, sepse të drejtën e fjalës mund t'ua hiqni me një të rënë të butonit. Madje, mund të thoni: “Çfarë flasim këta, çfarë bëhet sot, si ka mundësi që flitet për këto probleme, kur ne kemi probleme të tjera?”. Kjo ndodh, sepse nuk njihni realitetin dhe situatën e qytetarëve shqiptarë, të cilët përballen dita-ditës me vështirësi të panumërta nga ligjet që ju keni kaluar, nga mënyra se si e bëni politikën dhe nga arroganca e tepërt që po u krijon pështirosje të gjithë qytetarëve shqiptarë. Dua të them se, pavarësisht se diskutimi im sot nuk ishte për projektligjin që do të diskutohej, sepse kisha 4-5 seanca që nuk më jepej e drejta e fjalës për të diskutuar për të gjitha problemet që doja të parashtroja, shpresoj shumë që, pasi tregova që nuk kam marrë përgjigje nga institucionet përkatëse, të marr së paku një përgjigje, sepse më detyrohen kaq.

Së fundi, shpresoj të ketë një zgjidhje për të gjithë banorët shqiptarë, sepse në fund të ditës opozita do të vazhdojë të jetë në krah të qytetarëve dhe do të jetë gjithmonë në krahun e së drejtës. Edhe unë personalisht do të jem gjithmonë në krahun e qytetarëve, të cilët janë të pambrojtur kundrejt çdo koncesioni dhe çdo ligji, i cili është votuar me duartrokitje për të garantuar demokracinë. Faleminderit!